



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2018 – Numri: 185

Tiranë – E hënë, 24 dhjetor 2018

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 126/2018, datë 20.12.2018	Për rrëzimin e dekretit nr. 10 929, datë 5.11.2018, të Presidentit të Republikës, “Për propozimin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit” 14041
Vendim i Kuvendit nr. 129/2018, datë 20.12.2018	Për zgjedhjen e zonjës Suela Popa anëtare e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë..... 14041
Vendim i Kuvendit nr. 130/2018, datë 20.12.2018	Për zgjedhjen e zonjës Edlira Luçi anëtare e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë..... 14041
Vendim i Kuvendit nr. 131/2018, datë 20.12.2018	Për zgjedhjen e zotit Ridvan Bode anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë..... 14041
Vendim i Kuvendit nr. 132/2018, datë 20.12.2018	Për zgjedhjen e zotit Artan Hoxha anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë..... 14042
Vendim i Kuvendit nr. 133/2018, datë 20.12.2018	Për zgjedhjen e zonjës Luljeta Minxhozi anëtare e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë..... 14042
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 745, datë 19.12.2018	Për miratimin e marrëveshjes kuadër, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi, për marrëdhëniet e ndërsjella në menaxhimin e burimeve ujore ndërkufitare..... 14042
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 746, datë 19.12.2018	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” 14049
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 747, datë 19.12.2018	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 124, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”.. 14052

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 748, datë 19.12.2018	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”.....	14053
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 19.12.2018	Për disa ndryshime në vendimin nr. 933, datë 2.7.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për përfaqësimin e Ministrisë së Brendshme me oficerë kontakti në Britaninë e Madhe, Belgjikë, Itali, Greqi, Turqi, Kosovë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Gjermani, Francë, Europol dhe Interpol”, të ndryshuar.....	14054
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 751, datë 19.12.2018	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 910, datë 21.12.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për çështjet, objekt konsultimi, dhe strukturën, procedurën, formën, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të qeverisjes qendrore me vetëqeverisjen vendore”.....	14054
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 752, datë 19.12.2018	Për miratimin e rregullores së organizimit, funksionimit dhe përcaktimit të masës së shpërblimit të anëtarëve të Bordit të Apelit të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale.....	14055
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 753, datë 19.12.2018	Për miratimin e letërmarrëveshjes ndryshuese nr. 2 të marrëveshjes së Grantit nr. TF0A1769, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, që vepron si administratore e fondeve të grantit të akorduar nga Fondi i Mirëbesimit me Shumë Donatorë, për financimin e projektit të zbatimit të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse në Shqipëri (EITI).....	14058
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 754, datë 19.12.2018	Për shpërblimin dhe kompensimin e disa kategorive të veçanta për festat e fundvitit 2018.....	14059
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 755, datë 19.12.2018	Për disa ndryshime në vendimin nr. 752, datë 13.12.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për emërimin e kryetarit dhe të anëtarëve të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Aviacionit Civil”.....	14060
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 756, datë 19.12.2018	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Zgjerimi i varrezave publike”, Bashkia Cërrik.....	14060
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 757, datë 19.12.2018	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Rehabilitimi i rrjetit rrugor, Bashkia Shijak”, loti I.....	14063
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 758, datë 19.12.2018	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Zgjerimi i rrugës hyrëse të qytetit, parkimi dhe rikualifikimi i qendrës së qytetit Krujë”.....	14065

Vendim i Këshillit të Ministrave
nr. 759, datë 19.12.2018

Për disa ndryshime në vendimin nr. 490, datë 19.7.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Vlora - ACU, rikualifikim urban në qytetin e Vlorës, përgjatë ‘P4 C2 A, B, C’” dhe ‘Ndërtim i rrugës – vazhdimi i unazës Vlorë – Uji i Ftohtë’”

14067

Urdhër i Autoritetit për
Informimin mbi Dokumentet e
ish-Sigurimit të Shtetit nr. 59,
datë 18.12.2018

Për delegimin e kompetencave.....

14071

**VENDIM**
Nr. 126/2018**PËR RRËZIMIN E DEKRETIT NR. 10**
929, DATË 5.11.2018, TË PRESIDENTIT
TË REPUBLIKËS, “PËR PROPOZIMIN E
KRYETARIT TË KONTROLLIT TË
LARTË TË SHTETIT”

Në mbështetje të neneve 58, pika 2, dhe 111 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Mosmiratimin e kandidaturës së zonjës Vitore Tusha dhe rrëzimin e dekretit nr. 10 929, datë 5.11.2018, të Presidentit të Republikës, “Për propozimin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 20.12.2018

VENDIM
Nr. 129/2018**PËR ZGJEDHJEN E ZONJËS**
SUELA POPA ANËTARE E KËSHILLIT
MBIKËQYRËS TË BANKËS
SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 44, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, si dhe të nenit 111, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zonja Suela Popa zgjidhet anëtare e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 20.12.2018

VENDIM
Nr. 130/2018**PËR ZGJEDHJEN E ZONJËS**
EDLIRA LUÇI ANËTARE E KËSHILLIT
MBIKËQYRËS TË BANKËS
SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 44, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, si dhe të nenit 111, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zonja Edlira Luçi zgjidhet anëtare e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 20.12.2018

VENDIM
Nr. 131/2018**PËR ZGJEDHJEN E ZOTIT**
RIDVAN BODE ANËTAR I KËSHILLIT
MBIKËQYRËS TË BANKËS
SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 44, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, si dhe të nenit 111, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Ridvan Bode zgjidhet anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 20.12.2018

**VENDIM**
Nr. 132/2018**PËR ZGJEDHJEN E ZOTIT ARTAN
HOXHA ANËTAR I KËSHILLIT
MBIKËQYRËS TË BANKËS SË
SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 44, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, si dhe të nenit 111, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**VENDOSI:**

- I. Zoti Artan Hoxha zgjidhet anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 20.12.2018

VENDIM
Nr. 133/2018**PËR ZGJEDHJEN E ZONJËS
LULJETA MINXHOZI ANËTARE E
KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË BANKËS
SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 44, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, si dhe të nenit 111, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**VENDOSI:**

- I. Zonja Luljeta Minxhozi zgjidhet anëtare e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 20.12.2018

VENDIM
Nr. 745, datë 19.12.2018**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES
KUADËR, NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
MALIT TË ZI, PËR MARRËDHËNIET E
NDËRSJELLA NË MENAXHIMIN E
BURIMEVE UJORE NDËRKUFITARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes kuadër, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi, për marrëdhëniet e ndërsjella në menaxhimin e burimeve ujore ndërkufitare, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

**MARRËVESHJE KUADËR
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE QEVERISË SË MALIT TË ZI
PËR MARRËDHËNIET E NDËRSJELLA NË
MENAXHIMIN E BURIMEVE UJORE
NDËRKUFITARE**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Malit të Zi, më poshtë të referuara si “Palët”,

të udhëhequr nga qëllimi për zhvillimin e bashkëpunimit të drejtpërdrejtë dhe afatgjatë në fushën e menaxhimit të ujërave ndërkufitare me interes të përbashkët,

me synim dhënien e kontributit në përmirësimin e marrëdhënieve të përgjithshme të ndërsjella, si dhe marrëdhënieve në rajon,

duke pasur parasysh përpjekjet e Palëve, në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian (më poshtë i referuar si “BE”), harmonizojnë



rregulloret e tyre me legjislacionin komunitar në fushën e sektorit të ujërave dhe mjedisit, veçanërisht në lidhje me dispozitat e Direktivës 2000/60/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 23 tetor 2000 (Direktiva e BE-së Kuadër e Ujërave, më poshtë e referuar si “FDW”),

bazuar në detyrimin për respektimin dhe përmbushjen e standardeve dhe parimeve të ligjit të ujit dhe mjedisit të përcaktuara nga Konventa për Mbrojtjen dhe Përdorimin e Ujërave Ndërkufitare dhe Liqeneve Ndërkombëtare (Helsinki, 1992), Konventa për Ligjin për Përdorim jolundrues të Ujërave Ndërkombëtare (Nju-Jork, 1997), Konventa ESPOO (Finlandë, 1991), Konventa Ramsar (1971) për ligatinat me rëndësi ndërkombëtare, veçanërisht si habitate të shpendëve të ujit, Konventa për Mbrojtjen e Detit Mesdhe nga Ndotja (Barcelonë, 1976) dhe të gjitha protokollet, të miratuara në bazë të kësaj Konvente, si dhe traktate të tjera ndërkombëtare dhe akte të tjera ligjore,

në bazë të nevojës për të krijuar një menaxhim të integruar të burimeve ujore ndërkufitare në interes të Palëve, në përputhje me instrumentet ndërkombëtare ligjore në këtë fushë, detyruese për Palët, veçanërisht Direktivën Kuadër të Ujit.

Në përputhje me ligjet kombëtare dhe ndërkombëtare të dy shteteve, palët kanë arritur marrëveshjen kuadër si më poshtë:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Objekti i kësaj marrëveshjeje kuadër (më poshtë e referuar si “Marrëveshja”) është angazhimi i përbashkët për zgjidhjen e të gjitha çështjeve, duke përfshirë edhe punët dhe aktivitetet, si dhe lehtësirat e bashkëpunimit në fushën e menaxhimit të qëndrueshëm të ujërave të ëmbla ndërkufitare, nga ku të dyja ose njëra nga Palët janë të interesuara, për shkak të ndikimit të tyre në ndryshimet në sasinë dhe cilësinë e ujit.

Neni 2

Fushat e bashkëpunimit

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje i referohen interesave të përbashkëta, ndërhyrjeve për lehtësimin e menaxhimit të ujërave (nga të cilat hidrocentralet dhe planet e menaxhimit për Shkodrën/liqenin e Shkodrës dhe lumenjtë Drini, Buna dhe Moraça janë të një rëndësie të veçantë), aktiviteteve dhe ngjarjeve, të cilat kanë ose mund të kenë, nga pikëpamja e menaxhimit të ujit, ndikim në ujëra, veprat ujore dhe pajisjet për përdorimin e ujit, kontrollit të erozionit dhe mbrojtjes nga përmytjet, në mënyrë të veçantë, për:

- a) Bilancin e burimeve ujore;
- b) Ruajtjen dhe mbrojtjen nga ndikimet e dëmshme të ujërave;
- c) Rregullimin dhe mirëmbajtjen e rrjedhave të ujit;
- d) Mbrojtjen e ujërave ndërkufitare nga ndotja;
- e) Përdorimin dhe menaxhimin e veprave ujore ndërkufitare të përbashkëta;
- f) Përdorimin e të gjitha ujërave ndërkufitare të interesit të përbashkët (nga të cilat ujërat e Liqenit të Shkodrës, Drinit, Bunës, Moraçës, Grnçarit dhe lumit Cem);
- g) Eksplorimin e ndikimit të ndërhyrjeve të veprimeve të menaxhimit të ujit në mjedis;
- h) Njoftimin e ndërsjellë, informimin, konsultimin dhe shkëmbimin e përvojës dhe bashkëpunimit në nivel rajonal dhe nivele të tjera të organizimit dhe lidhjes në fushën e ujërave;
- i) Njoftimin paraprak për rastet e shkarkimeve të mëdha nga ujëmbledhësi, të cilat mund të sjellin përmytje në vendin e një pale, duke ndikuar dhe në territorin e palës tjetër.

Neni 3

Përkufizimet

Përkufizimet e zbatuara në këtë Marrëveshjeje kanë kuptimet e mëposhtme:

1. “Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve ujore” nënkupton një menaxhim i integruar i burimeve ujore që në raport me mundësitë natyrore, hidrogeologjike, hidrologjike dhe teknike, ofron:

a) sasi të mjaftueshme të ujit dhe cilësi të duhur për ruajtjen, mbrojtjen dhe përmirësimin e ekosistemeve ujore, dhe ekosistemeve tokësore dhe ligatinore që janë drejtpërdrejt të varur nga ekosistemi ujor;



b) Sasi të mjaftueshme të ujit me cilësi të përshtatshme për të gjitha llojet e shfrytëzimit të ujit;

c) Mbrojtje nga ndotjet;

d) Mbrojtje nga ndikimet negative të ujit;

e) Zgjidhje të konfliktit të interesave dhe përshtatje ndaj formave të ndryshme të përdorimit të ujit, me kusht që çdo ndryshim në përdorimin ekzistues të bëhet me marrëveshje ndërmjet Palëve;

f) Ndarje të arsyeshme dhe të drejtë në përdorimin ekzistues dhe të ardhshëm të ujit, duke përfshirë detyrimin e kompensimit për palën e prekur nga dëmet, të shkaktuara nga ndikimet ndërkufitare, si edhe,

g) Kontroll efikas të regjimit ujqor dhe veprave ujqore.

2. “Ujërat ndërkufitare” nënkupton ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore, të cilat përshkojnë ose janë të lokalizuara në kufijtë midis dy ose më shumë shteteve.

3. “Ujërat me interes të përbashkët” nënkupton të gjitha ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore, duke përfshirë rrjedhat e ujit dhe zonat e tyre të mbulimit, të cilat janë të ndarë përmes kufirit shtetëror ose ndodhen në zonat e tyre ujëmbledhëse që për shkak të ndikimit në ndryshimin e sasisë ose cilësisë së ujit ose ndikimit ndërkufitar, janë me interes për njërën ose të dyja Palët;

4. “Ndikimi ndërkufitar” nënkupton çdo pasojë nga përdorimi i ujit apo një ndryshim në regjimin e ujit, i shkaktuar nga veprimtaria e njeriut si pasojë e ndërhyrjes së njëres Palë në territorin e saj që mund të ndikojë në jetën dhe pronën, sigurinë e veprave ujqore dhe mjedisit, në territorin e Palës tjetër, të cilat mund të shprehen saktësisht bazuar në njohuritë e të dyja Palëve.

5. “Ndërhyrja” nënkupton çdo aktivitet ekzistues, i iniciuar apo i planifikuar për të ardhmen, në lidhje me ujin, i cili ka ose mund të shkaktojë ndikim ndërkufitar;

6. “Dëmet nga ndikime ndërkufitare” lidhen me çdo dëm të shkaktuar nga ndërhyrja, e cila kishte ose ka ndikim në jetën, pronën, sigurinë e objektit, në mjedisin ose strukturën ujqore në territorin e palës tjetër ose nëpërmjet të cilave disa prej të drejtave apo interesave janë shkelur;

7. “Veprat ujqore” nënkupton struktura apo grup strukturash, së bashku me pajisjet shoqëruese të cilat përbëjnë një njësi teknike ose teknologjike

dhe shërbejnë për menaxhimin e integruar të ujit, rregullimin e ujit dhe burimeve ujqore, mbrojtjen nga ndikimet negative të ujit, mbrojtjen e ujërave nga ndotja, sigurimin e ujit dhe krijimin e kushteve për një shumëllojshmëri të shfrytëzimit dhe përdorimit të ujit;

8. “Ndotja aksidentale” nënkupton ndotjen e papritur që ndodh si rezultat i çdo aktiviteti apo ngjarjeje që përfshijnë substancat e rrezikshme dhe agentët e tjerë të padëshirueshëm të cilat sjellin pasoja të drejtpërdrejta apo të tërthorta, të menjëhershme apo të mëvonshme për shëndetin apo sigurinë e popullsisë, florës, faunës, tokës, ajrit, ujit, klimës, peizazhit apo monumenteve historike, si dhe ndikimet në trashëgiminë kulturore apo kushtet socio-ekonomike, të cilat janë rezultat i ndryshimeve në këta faktorë;

9. “Statusi i ujit” nënkupton gjendjen e një trupi ujqor, e përcaktuar nga statusi i tij sasior dhe cilësor.

Neni 4

Parimet bazë

Palët bashkëpunojnë mbi bazën e parimit të barazisë sovrae, integritetit territorial, reciprocitetit, përfitimit të ndërsjellë dhe në mirëbesim.

Të gjitha ndërhyrjet dhe aktivitetet (aktuale dhe të ardhshme) në kuadër të kësaj Marrëveshjeje, bazohen në parimet e parandalimit, masat paraprake, pa shkaktuar dëme, zbatimin e parimit “kush ndot, paguan”, zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe përdorimin e arsyeshëm dhe të drejtë të ujit, dhe në lidhje me mbrojtjen e mjedisit përdorimin e duhur të ujit në mënyrë të qëndrueshme.

Palët sigurojnë transparencë të plotë në procesin e vendimmarrjes, duke iu referuar çështjeve, të cilat janë objekt i kësaj Marrëveshjeje.

KREU II

BASHKËPUNIMI

Neni 5

Mënyrat e bashkëpunimit

Për qëllim të kësaj Marrëveshjeje, Palët duhet të bashkëpunojnë nëpërmjet:

a) Shkëmbimit të rregullt dhe në kohë të të dhënave dhe informacionit të plotë dhe të saktë për të gjitha çështjet që janë objekt i kësaj Marrëveshjeje,



b) Konsultimeve, koordinimit dhe përfshirjes aktive në kryerjen e punimeve të Komisionit Shqiptaro-Malazez për Menaxhimin e Ujërave me interes të Përbashkët, të përmendura në nenin 16 të kësaj Marrëveshjeje (më poshtë i referuar si “Komisioni për Menaxhimin e Burimeve Ujore”) dhe organeve të formuara pranë tij,

c) Zbatimit aktiv të masave ligjore, organizative, institucionale, teknike, ekonomike dhe të tjera, të nevojshme për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Në realizimin e bashkëpunimit ndërmjet Palëve, detajet e mëtejshme mbi marrëdhëniet, të cilat janë objekt i kësaj Marrëveshjeje, rregullohen me akte të përbashkëta të Palëve.

Neni 6

Përdorimi i burimeve ujore

Palët duhet të sigurojnë përdorim të drejtë, të arsyeshëm dhe të qëndrueshëm të burimeve ujore në dispozicion, bazuar në bilancin e burimeve ujore me interes të përbashkët, planet e koordinuara dhe projektet, aktet e menaxhimit të ujit dhe kritere të tjera përkatëse.

Palët, me anë të akteve të veçanta, duhet të përcaktojnë më hollësisht, si në vijim: faktorët përkatës për përdorim të drejtë, të arsyeshëm dhe të qëndrueshëm të burimeve ujore me interes të përbashkët; metodën për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve për përdorim praktik të burimeve ujore me interes të përbashkët; metodologjinë për zhvillimin e bilancit të tyre, si edhe metodën e matjes së rrjedhës së burimeve ujore dhe përcaktimin e sasisë së disponueshme të ujit.

Neni 7

Mbrojtja e burimeve ujore

Palët ndërmarrin masa për parandalimin e përkeqësimit dhe përpiqen të përmirësojnë statusin e burimeve ujore me interes të përbashkët.

Palët bien dakord, sipas rastit, në bazë të metodologjisë së miratuar reciprokisht, bazuar në FDW, për kontrollin e rregullt të cilësisë së burimeve ujore, si dhe për vlerësimin bashkërisht të statusit dhe tendencës së ndryshimit të statusit të burimeve ujore mbi baza të rregullta, sipas kritereve të rena dakord për cilësinë e ujit dhe metodologjisë për vlerësimin dhe përcaktimin e rezultateve të testimit.

Palët ndërmarrin masa për parandalimin dhe eliminimin e pasojave të ndotjes aksidentale dhe të substancave dhe përbërësve të rrezikshëm, për të arritur gjendjen e mirë të ujit në burime të caktuara të ndotjes.

Palët pranojnë listën e substancave të rrezikshme nga Direktiva Kuadër e Ujit.

Palët konsultohen mbi dhënien e lejeve ujore dhe akteve të tjera të ujit për objektet e reja ose rikonstruktimin e objekteve ekzistuese në territorin që është objekt i kësaj Marrëveshjeje, aplikojnë teknologjinë më të avancuar për trajtimin e ujërave të përdorura të shkarkuara në trupat ujorë me interes të përbashkët, dhe respektojnë reciprokisht vlerat kufi të miratuara të parametrave të cilësisë së këtyre ujërave.

Palët marrin në konsideratë rregullat përkatëse të BE-së, duke respektuar vlerat kufi të parametrave të cilësisë së ujit, të përcaktuara në Direktivën Kuadër të Ujit.

Në rastin e ndikimit ndërkufitar të burimeve të caktuara të ndotjes në cilësinë së ujit, Palët ndërmarrin masa për të reduktuar këtë ndikim dhe për ta vënë nën kontroll.

Palët kryejnë vlerësimin e rrezikut për faktorët ndotës parësorë të rrezikshëm në zhvillimin e strategjive kundër ndotjes së ujit.

Palët njoftojnë njëra-tjetrën, në një afat sa më të shkurtër të mundshëm, nëse ndodh ndotja aksidentale, e cila si rezultat mund të ketë ndikim ndërkufitar ose ky ndikim mund të ndodhë. Me kërkesën e palës së prekur, pala tjetër do të bashkëpunojë për reduktimin dhe eliminimin e pasojave.

Palët ndërmarrin masa për ndërhyrje në zonat e prekura të ujërave me interes të përbashkët, me qëllim minimizimin e pasojave të ndotjes aksidentale nga nënproduktet e naftës apo ndotësve të tjerë lundrues, sipas nevojës.

Palët rregullojnë bashkëpunim më të hollësishëm në fushën e mbrojtjes së burimeve ujore nëpërmjet një akti të veçantë, sipas nevojës.

Neni 8

Mbrojtja nga ndikimet e dëmshme të burimeve ujore

Palët ndërmarrin masat e nevojshme për mbrojtjen nga ndikimet e dëmshme të burimeve ujore me interes të përbashkët, nuk kryejnë veprime në mënyrë të njëanshme dhe nuk



ndërmarrin masa, të cilat në territorin e njëres palë mund të shkaktojnë ndikime negative në burimet ujore me ndikim ndërkufitar.

Palët rregullojnë në mënyrë sa më të hollësishme çështjet me rëndësi për mbrojtjen nga ndikimet e dëmshme të ujërave, me anë të një akti të veçantë, sipas nevojës.

Neni 9

Veprat ujore dhe burimet ujore

Në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, Palët:

a) Në mënyrë të ndërsjellë ruajnë në gjendje të mirë të gjitha veprat ujore dhe pajisjet, shtratin e ujit dhe kanalet, të cilat janë objekt i kësaj Marrëveshjeje,

b) Veprojnë sipas marrëveshjes në trajtimin dhe operimin e veprave ujore të ujit dhe pajisjeve,

c) Me marrëveshje të përbashkët kryejnë ndryshimin apo ndërtimin e veprave ujore dhe pajisjeve, si dhe ndërmarrin punime dhe masa të reja të cilat mund të kenë ndikim në regjimin e ujërave me interes të përbashkët.

Palët mund të nënshkruajnë marrëveshje të veçanta për ndërtimin, përdorimin dhe mirëmbajtjen e veprave ujore të caktuara me rëndësi apo veprave ujore me ndikim të lartë ndërkufitar.

Neni 10

Monitorimi, shkëmbimi dhe analizimi i të dhënave dhe informacionit

Palët sigurojnë monitorimin e duhur për të vlerësuar sasinë, cilësinë dhe gjendjen e ujit.

Palët duhet të bien dakord për shkëmbimin dhe qëllimin e informacionit të kërkuar mbi hidrogeologjinë, konsumin dhe veprat e marrjes të ujit, mënyrën e operimit, impiantet dhe statusin e veprave ujore, si dhe informacione të tjera të nevojshme në lidhje me parandalimin, vlerësimin dhe eliminimin e ndikimeve ndërkufitare.

Përveç shkëmbimit të të dhënave të mbledhura në rrjetet e tyre të monitorimit, Palët paraqesin aktivitetet për të cilat kanë rënë dakord bashkërisht, të planifikuara për monitorimin e sasive dhe /ose statusit të burimeve ujore në territorin që është çështje e objektit të kësaj Marrëveshjeje, dhe që do të përdoren për paralajmërimin në rast të ngjarjeve të rrezikshme, sipas nevojës.

Faqe | 14046

Neni 11

Sigurimi i financimit për zbatimin e projekteve

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje zbatohen për përpjekjet e përbashkëta në sigurimin e burimeve të nevojshme financiare (duke përfshirë ndihmën ndërkombëtare ose tjetër) nga burime të brendshme dhe ndërkombëtare, për zbatimin e projekteve në fushën e bashkëpunimit të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 12

Bashkëpunimi me vendet fqinje

Palët, në mënyrë të koordinuar, përmirësojnë bashkëpunimin me vendet e tjera dhe veçanërisht me vendet fqinje dhe, nëse është e nevojshme, ky bashkëpunim mund të rregullohet me anë të një kontrate të ndërsjellë, duke respektuar detyrimet e parashikuara nga kjo Marrëveshje.

Neni 13

Përgjegjësia për dëmet e ndikimeve ndërkufitare dhe kompensimi

Palët duhet të ndërmarrin të gjitha masat e duhura për të parandaluar dëmet e konsiderueshme ndaj palës tjetër, kur përdorin burimet ujore me interes të përbashkët në territoret e tyre, pasi të kenë rënë më parë dakord me palën tjetër ose të kenë marrë miratimin nga autoriteti i saj kompetent.

Nëse dëmi i konsiderueshëm i është shkaktuar një Pale, Pala që ka përdorur burimet ujore me interes të përbashkët dhe ka shkaktuar dëmin, në mungesë të marrëveshjes së lidhur ose miratimit të një akti tjetër të dhënë nga autoritetet kompetente të Palës së prekur për një përdorim të tillë, do të ndërmarrë të gjitha masat e duhura, në përputhje me ligjin përkatës ndërkombëtar dhe këtë Marrëveshje, në konsultim me Palën e prekur, me qëllim eliminimin dhe parandalimin e një dëmi të tillë, dhe nëse është e nevojshme, do të diskutojë çështjen e kompensimit.

Palët, sipas nevojës, në përputhje me këtë Marrëveshje dhe ligjin ndërkombëtar, në përputhje me akte të veçanta, mund të vendosin parimet dhe procedurat përkatëse që do të zbatohen në përcaktimin e dëmeve të ndikimeve ndërkufitare, përgjegjësinë për ndodhjen e dëmit dhe tarifave ose kompensimit të dëmeve. Hartimi



i këtij dokumenti nuk duhet të jetë shkak vonese në përcaktimin e tarifave të kompensimit të dëmit.

Tarifa ose kompensimi i dëmit në bazë të kësaj Marrëveshjeje, i referohet dëmit me ndikim ndërkufitar, nëse dëmi është shkaktuar si pasojë e ndërhyrjeve për të cilat nuk ka marrëveshje me Palën e dëmtuar që rregullon çështjen e dëmit të mundshëm. Për vlerësimin e dëmit, Palët formojnë grupe pune (komisione, nënkomisione) në kërkesë të Palës së dëmtuar.

Në rastin e përmendur në paragrafin 4 të këtij neni, tarifa e dëmit apo kompensimi i Palës së prekur do të zbatohet nga data e kryerjes së ndërhyrjes.

Neni 14

Mirëmbajtja e pikave kryesore gjeodezike

Palët, secila në territorin e saj kombëtar dhe me shpenzimet e veta, duhet të mbajnë, ruajnë dhe nëse është e nevojshme, të ndryshojnë dhe të rivendosin pikat kryesore gjeodezike, shenjat dhe matësit e ujit, të cilat përdoren për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e objekteve ujore dhe rinovimin e aktiviteteve ujore, në ujërat me interes të përbashkët. Palët do të venë të dhënat mbi këto pika në dispozicion të palës tjetër, sipas kërkesës.

Neni 15

Informimi publik dhe konsultimi

Palët inkurajojnë përfshirjen aktive të të gjithë aktorëve në aktivitete, të rëndësishme për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, veçanërisht në prodhimin, rishikimin dhe përditësimin e planeve ose projekteve që lidhen me menaxhimin e ujit.

KREU III

KOMISIONI PËR MENAXHIMIN E BURIMEVE UJORE DHE ORGANET E TIJ

Neni 16

Themelimi, përbërja dhe formimi

Më qëllim arritjen e bashkëpunimit në menaxhimin e burimeve ujore, me interes të përbashkët, Palët do të krijojnë një Komision të përhershëm për Menaxhimin e Burimeve Ujore, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

Komisioni për Menaxhimin e Burimeve Ujore përbëhet nga 20 anëtarë. Çdo Palë emëron 10 anëtarët e saj në Komisionin për Menaxhimin e Burimeve Ujore.

Palët informohen për emërimin e anëtarëve të Komisionit për Menaxhimin e Burimeve Ujore nëpërmjet rrugëve diplomatike. Në të njëjtën mënyrë, Palët njoftohen në lidhje me ndërprerjen e anëtarësimit të një personi të emëruar në Komision dhe për emërimet e reja në afatin më të shkurtër të mundshëm.

Komisioni për Menaxhimin e Burimeve Ujore do të formohet jo më vonë se 30 ditë nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 17

Detyrat dhe objekti i punës së Komisionit për Menaxhimin e Burimeve Ujore

Në përputhje me këtë Marrëveshje, kompetencat, detyrat dhe objektivat e punës së Komisionit për Menaxhimin e Burimeve Ujore do të përcaktohen në Rregulloren e Punës së këtij Komisioni, e cila do të miratohet në seancën e parë të mbledhjes së tij.

Neni 18

Krijimi i organeve të punës të Komisionit për Menaxhimin e Burimeve Ujore dhe Angazhimi i Ekspertëve

Komisioni për Menaxhimin e Burimeve Ujore, në përputhje me nevojat, do të krijojë nënkomisione të përhershme, nënkomisione të posaçme dhe grupe ekspertësh, dhe mund të punësojë ekspertë individualë, për çështje specifike dhe për të hartuar propozime për zgjidhjen e tyre apo për pajtimin dhe zbatimin e detyrave të interesit të përbashkët.

Punët administrative për nevojat e Komisionit për Menaxhimin e Burimeve Ujore do të kryhen nga organet ose autoritetet e Palëve përgjegjëse për bashkëpunim ndërkombëtar në fushën e çështjeve të ujërave.

Neni 19

Procesi i vendimmarrjes dhe procesverbalet e mbledhjeve

Komisioni për Menaxhimin e Burimeve Ujore miraton unanimisht vendimet, konkluzionet etj.

Komisioni për Menaxhimin e Burimeve Ujore përgatit procesverbalin për çdo seancë në të tre gjuhët, malazeze, shqipe dhe angleze.



Neni 20

Transparenca e punimeve të Komisionit për Menaxhimin e Burimeve Ujore

Komisioni për Menaxhimin e Burimeve Ujore duhet që, në mënyrë të rregullt, brenda afateve kohore të caktuara në legjislacionet përkatëse dhe në mënyrë të hollësishme të informojë publikun për punimet/aktivitetet e tij.

Në mënyrë që të arrihet transparenca e punës, Palët duhet të sigurojnë kushte për pjesëmarrjen e publikut në punët e Komisionit për Menaxhimin e Burimeve Ujore, si edhe në zbatimin e vendimeve të marra.

KREU IV**AUTORITETET E TJERA**

Neni 21

Autoritetet kompetente, organet dhe shoqatat e tjera

Autoritetet kompetente, organet dhe shoqatat e përfshira në aktivitetin e Palëve në fushën e burimeve ujore ose që me veprimtarinë e tyre, nga pikëpamja e menaxhimit të burimeve ujore, kanë ose mund të kenë ndikim në burimet ujore, veprat ujore dhe pajisjet për përdorimin e ujit, do të vendosin kontakte të drejtpërdrejta, si dhe të gjitha format e tjera të bashkëpunimit ndërkombëtar për kryerjen e aktiviteteve të kërkuara në zbatim të kësaj Marrëveshjeje.

Kontaktet dhe bashkëpunimi, të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, kufizohen nga legjislacioni kombëtar dhe kjo Marrëveshje dhe nuk duhet të jenë në konflikt me autoritetet e caktuara të Palëve dhe Komisionin për Menaxhimin e Burimeve Ujore, si dhe masat dhe rregulloret e miratuara në këtë mënyrë.

KREU V**SHPENZIMET**

Neni 22

Shpenzimet e Komisionit për Menaxhimin e Burimeve Ujore

Shpenzimet e organizimit dhe mbajtjes së seancës së Komisionit për Menaxhimin e Burimeve Ujore, takimet e nënkomisioneve dhe takimet e ekspertëve do të mbulohen nga Pala në territorin e së cilës do të zhvillohet takimi ndërkombëtar. Shpenzimet e pjesëmarrjes në seancën e Komisionit dhe takime të tjera mbulohen nga secila Palë për përfaqësuesit e saj.

Faqe | 14048

Neni 23

Shpenzime të tjera

Palët, me marrëveshje, përcaktojnë shpenzimet, ndarjen e shpenzimeve, si dhe mënyrën e pagesës për mirëmbajtjen dhe funksionimin e veprave ujore ekzistuese, si dhe planifikimin, projektimin dhe ndërtimin e veprave ujore të ardhshme dhe të objekteve që janë me interes të përbashkët, pavarësisht se në cilin shtet ndodhen, si dhe aktivitete të tjera në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Shpenzimet që lindin në përputhje me planifikimin, projektimin, ndërtimin, mirëmbajtjen e veprave ujore dhe impianteve, të cilat janë të vendosura në territorin kombëtar të një Pale dhe shërbejnë për interesat e Palës tjetër, mbulohen plotësisht nga Pala e interesuar.

Shpenzimet e riparimit të ndotjes aksidentale, si dhe shpenzimet që rrjedhin nga përgjegjësia për dëmet e ndikimeve ndërkufitare kryhen nga Pala që është përgjegjëse për ndotjen ose dëmtimin.

Çështjet financiare dhe tatimore që lindin nga zbatimi i kësaj Marrëveshjeje do të trajtohen në përputhje me legjislacionin në fuqi të palëve.

Pagesa e ekspertëve të jashtëm do të rregullohet në përputhje me legjislacionin në fuqi të vendit përkatës.

Kur Palët kanë nevojë dhe mundësi të mbulojnë një pjesë të shpenzimeve të nevojshme për zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje duke përdorur fondet ndërkombëtare, Palët veprojnë në mënyrë të koordinuar dhe bashkëpunojnë për dhënie të ndihmës financiare dhe zbatimin e projektit.

Çështjet financiare të lidhura me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, të cilat nuk rregullohen nga kjo Marrëveshje ose rregulloret e miratuara në përputhje me këtë Marrëveshje, rregullohen me marrëveshje të ndërsjellë.

Neni 24

Procedurat doganore

Palët reciprokisht duhet të sigurojnë procedura të thjeshtuara doganore për mallrat, sipas legjislacionit doganor në fuqi, të nevojshme për zbatimin e projekteve të planifikuara dhe arritjen e qëllimeve, si dhe lëvizje të lirë të personave që kryejnë punë nga njëra palë në tjetrën, në përputhje me këtë Marrëveshje.



Për zbatimin e detyrimeve të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, autoritetet kompetente të Palëve mund të lidhin një marrëveshje të veçantë, sipas nevojës.

Neni 25

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët do të përpiqen të zgjidhin në mënyrë miqësore çdo çështje në interpretimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe çdo mosmarrëveshje që mund të rrjedhë prej saj, brenda Komisionit për Menaxhimin e Burimeve Ujore.

Çështjet për të cilat nuk arrihet miratimi brenda Komisionit për Menaxhimin e Burimeve Ujore, do të zgjidhen në mënyrë miqësore nga Palët, nëpërmjet rrugëve diplomatike në përputhje me legjislacionin ndërkombëtar.

Neni 26

Lidhja me marrëveshjet e tjera ndërkombëtare

Kjo Marrëveshje nuk cenon të drejtat dhe detyrimet ekzistuese të Palëve që rrjedhin nga marrëveshjet e tjera ndërkombëtare, të lidhura ndërmjet tyre dhe/ose në të cilat janë Palë.

Me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, shfuqizohen marrëveshja ndërmjet Qeverisë së republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi mbi problemet ujore nënshkruar më 31.10.2001, ndërsa Komisionet ekzistuese për menaxhimin e ujërave vazhdojnë punën e tyre deri në formimin e Komisionit për menaxhimin e burimeve ujore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Malit të zi, sipas kësaj Marrëveshjeje.

KREU VI

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 27

Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim për përmbushjen e kërkesave për hyrjen e saj në fuqi, nëpërmjet rrugëve diplomatike, në përputhje me procedurat e brendshme ligjore të Palëve.

Neni 28

Kohëzgjatja, ndryshimi dhe përfundimi

Kjo Marrëveshje do të lidhet për një periudhë të pacaktuar kohore.

Secila Palë mund të njoftojë Palën tjetër me shkrim, nëpërmjet rrugëve diplomatike, për përfundimin e kësaj Marrëveshjeje. Përfundimi do të ketë efekt njëvjeçar pas marrjes së një njoftimi të tillë.

Secila palë mund të propozojë ndryshime të kësaj Marrëveshjeje. Ndryshimet do të hyjnë në fuqi sipas procedurës së parashikuar në nenin 27, të kësaj Marrëveshjeje.

Nënshkruar në Shkodër, më 3 korrik 2018, në dy origjinale, në gjuhën shqipe, malazeze dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëloj autentike. Në rast mospërputhjes në interpretimin e neneve të kësaj Marrëveshjeje, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE
TË REPUBLIKË SË SHQIPËRISË

Senida MESI

Zëvendëskryeministre

PËR QEVERINË E MALIT TË ZI
Milutin SIMOVIĆ

Zëvendëskryeministër dhe ministër i
Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

VENDIM

Nr. 746, datë 19.12.2018

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 243, DATË 18.3.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PRANIMIN, LËVIZJEN PARALELE, PERIUDHËN E PROVËS DHE EMËRIMIN NË KATEGORINË EKZEKUTIVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 22, pika 6, 23, pika 5, 24, pika 5, e 25, pika 5, dhe të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Në kreun II bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në pikën 5, pas fjalëve “... dhe qëndron e publikuar ...” shtohet fjala “...të paktën ...”.



b) Pika 10 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“10. Shpallja është e hapur për të gjithë kandidatët nga jashtë shërbimit civil. Dokumentacioni duhet të dorëzohet brenda datës së përcaktuar në shpalljen për konkurrim. Kjo datë përcaktohet duke siguruar që afati i dorëzimit të dokumentacionit të mos jetë më i vogël se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike nga dita e parë e shpalljes në:

a) faqen zyrtare të DAP-it dhe portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, për institucionet e administratës shtetërore;

b) portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të internetit dhe në ambientet e brendshme, për institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore.”.

2. Në kreun IV bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikën 2, fjalët “... jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë kalendarike ...” zëvendësohen me “... jo më vonë se 16 (gjashtëmbëdhjetë) ditë kalendarike ...”.

b) Në pikën 6, fjalët “... nga data e depozitimit të ankesës ...” zëvendësohen me “... nga data e përfundimit të afatit të ankimit ...”.

c) Pas pikës 9 shtohet pika 9/1, me këtë përmbajtje:

“9/1. Nëse kandidati grumbullon më shumë se gjysmën e pikëve (mbi 30 pikë) nga vlerësimi me shkrim, ai kualifikohet për të kaluar në procesin e vlerësimit të jetëshkrimit.”.

ç) Në pikën 10, fjala “... e jetëshkrimit ...” hiqet.

d) Pika 11 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“11. Nëse kandidati grumbullon mbi 45 (dyzet e pesë) pikë nga vlerësimi me shkrim dhe vlerësimi i jetëshkrimit së bashku, ai kualifikohet për intervistën e strukturuar me gojë.”.

dh) Pas pikës 18 shtohen pikat 18/1 dhe 18/2, me këtë përmbajtje:

“18/1. Kandidatët që nuk paraqiten për të zgjedhur pozicionin e punës, sipas ftesës së bërë nga njësia përgjegjëse, pa shkaqe të arsyeshme, humbasin të drejtën e zgjedhjes nga lista e pozicioneve për të cilën janë ftuar të zgjedhin dhe të drejtën e qëndrimit në listën fituese.

Kandidatët që nuk paraqiten për të zgjedhur pozicionin e punës, sipas ftesës së bërë nga njësia përgjegjëse, për shkaqe të arsyeshme, njoftojnë njësinë përgjegjëse për pamundësinë e

pjesëmarrjes së tyre të paktën deri në orarin e përcaktuar prej saj për paraqitjen e kandidatëve. Në këtë rast njësia përgjegjëse shtyn datën e paraqitjes së kandidatëve fitues në një datë tjetër.

18/2. Në kuptim të pikës 18/1, të kreut IV, të këtij vendimi, shkaqe të arsyeshme konsiderohen:

a) Rastet e sëmundjeve të kandidatit fitues, fëmijëve të mitur apo bashkëshortit/es, vërtetuar me dokument mjekësor;

b) Vdekja e prindërve, bashkëshortit/es, fëmijës, vëllezërve, motrave;

c) Forcat madhore.”.

e) Pas pikës 19 shtohen pikat 19/1, 19/2 dhe 19/3, me këtë përmbajtje:

“19/1. Pas marrjes së aktit të emërimit, kandidati fitues detyrohet të paraqitet pranë institucionit ku është emëruar, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune nga data e marrjes së aktit.

19/2. Në rast të mosparaqitjes së kandidatit fitues, brenda afatit të përcaktuar në pikën 19/1, të kreut IV, të këtij vendimi, institucioni ku kandidati është emëruar, njofton njësinë përgjegjëse brenda 5 (pesë) ditëve pune nga përfundimi i afatit. Në këtë rast njësia përgjegjëse vijon procedurën me anulimin e aktit administrativ (akti i emërimit), në zbatim të dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative.

19/3. Institucionet detyrohen të nxjerrin aktin e fillimit të efekteve financiare të kandidatit të emëruar nga njësia përgjegjëse, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune nga data e paraqitjes së tij pranë institucionit. Ky afat mund të shtyhet me marrëveshje midis të dyja palëve, por jo më shumë se 1 (një) muaj nga data e nxjerrjes së aktit të emërimit nga njësia përgjegjëse.”.

ë) Pika 21 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“21. Njësia përgjegjëse, në kushtet e rezultatit pa asnjë fitues ose me më pak fitues se planifikimi, rihap procedurën e pranimit në shërbimin civil, bazuar në planin e zhvillimit të procedurës për secilin grup, të njoftuar nga ajo, sipas pikës 4, të kreut II, të këtij vendimi.”.

f) Pika 22 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“22. Kandidati, pavarësisht nga e drejta për t’u ankuar në gjykatën administrative, ka të drejtë të bëjë ankim me shkrim edhe në KPP, për rezultatin e pikëve dhe/ose renditjen në listën fituese. Afati i ankimit fillon brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga:



a) data e njoftimit individual të rezultatit të vlerësimit me shkrim, për kandidatët që kanë grumbulluar deri në gjysmën e pikëve (deri në 30 pikë) nga ky vlerësim;

b) data e njoftimit individual të rezultatit të vlerësimeve, për kandidatët që kanë grumbulluar deri në 45 (dyzet e pesë) pikë nga vlerësimi me shkrim dhe vlerësimi i jetëshkrimit;

c) data e njoftimit individual të rezultatit të vlerësimeve, për kandidatët të cilët kanë marrë pjesë në të tri fazat e vlerësimit të përcaktuara sipas pikës 7, të kreut IV, të këtij vendimi.

Të gjithë ankuesit marrin përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit ankimor të përcaktuar në shkronjën “c”, të kësaj pike. Në përfundim të këtij afati njësia përgjegjëse publikon listën përfundimtare fituese.”.

3. Në kreun VII bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në pikën 4, pas fjalëve “... qëndron në portal ...” shtohet fjala “... të paktën ...”.

b) Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Shpallja është e hapur për të gjithë nëpunësit civilë të së njëjtës kategori në të gjitha institucionet, pjesë të shërbimit civil. Dokumentacioni duhet të dorëzohet brenda datës së përcaktuar në shpalljen për vendin e lirë. Kjo datë përcaktohet duke siguruar që afati i dorëzimit të dokumentacionit të mos jetë më i vogël se 10 (dhjetë) ditë kalendarike nga dita e parë e shpalljes.”.

c) Në pikën 11, fjalët “... nga data e paraqitjes së tyre ...” zëvendësohen me “... nga data e përfundimit të afatit të ankimit ...”.

ç) Pas pikës 18 shtohen pikat 18/1 dhe 18/2, me këtë përmbajtje:

“18/1. Komisioni, në përfundim të vlerësimit rendit kandidatët sipas pikëve të grumbulluara dhe ia dërgon listën njësish së burimeve njerëzore të institucionit. Njësia e burimeve njerëzore të institucionit, brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga dita që komisioni i njofton vendimin e tij, njofton individualisht kandidatët që kanë konkurruar për rezultatit e tyre.

18/2 Kandidatët, pavarësisht nga e drejta për t’u ankuar në gjykatën administrative, kanë të drejtë të bëjnë ankim me shkrim edhe në komisionin e brendshëm për lëvizjen paralele për rezultatit e vlerësimit, brenda 3 (tri) ditëve

kalendarike nga data e njoftimit individual mbi rezultatit. Ankuesi merr përgjigje brenda 3 (tri) ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit.”.

d) Fjalja e parë e pikës 19 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Komisioni, brenda 24 (njëzet e katër) orëve pas përfundimit të procedurave të ankimit, sipas pikës 18/2, të kreut VII, të këtij vendimi, përzgjedh kandidatin, i cili renditet i pari ndër kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë (70% të pikëve).”.

dh) Në pikën 23 shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Kandidati fitues detyrohet të paraqitet pranë institucionit ku është emëruar, jo më vonë se 1 (një) ditë pune nga dita e përfundimit të dorëzimit të detyrës pranë institucionit të mëparshëm.”.

e) Pas pikës 23 shtohen pikat 23/1 dhe 23/2, me këtë përmbajtje:

“23/1. Në rast të mosparaqitjes së kandidatit fitues brenda afatit të përcaktuar në pikën 23, të kreut VII, të këtij vendimi, institucioni ku kandidati është emëruar, njofton njësinë përgjegjëse brenda 5 (pesë) ditëve pune nga përfundimi i afatit. Në këtë rast njësia përgjegjëse vijon procedurën me anulimin e aktit administrativ (akti i emërimit), në zbatim të dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative.

23/2 Institucioni ku nëpunësi civil është emëruar nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, detyrohet të nxjerrë aktin e fillimit të efekteve financiare jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune nga dita e paraqitjes së tij në institucion. Këto afate mund të shtyhen me marrëveshje midis të dyja palëve, por jo më shumë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune nga data e nxjerrjes së aktit të emërimit nga njësia përgjegjëse.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2019.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

**VENDIM****Nr. 747, datë 19.12.2018****PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 124, DATË 17.2.2016,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PEZULLIMIN DHE LIRIMIN NGA
SHËRBIMI CIVIL”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 55, pika 2, 56, pika 5, e 66, pika 5, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 124, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Në pikën 11 shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“E njëjta procedurë ndiqet edhe kur nëpunësi civil, i pezulluar për një nga rastet e parashikuara në pikën 10, të këtij vendimi, do të shtyjë afatin e pezullimit për të njëjtin shkak, por jo më shumë se afatet ligjore të përcaktuara në nenin 55, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe në këtë vendim.”.

b) Pika 13 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“13. Pas kërkesës së nëpunësit civil, njësia e burimeve njerëzore dhe Departamenti i Administratës Publike, sipas rastit, brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike:

a) Konstatojnë, me shkrim, pezullimin për rastet e parashikuara në shkronjat “a” e “b”, të pikës 10, të këtij vendimi;

b) miratojnë ose jo pezullimin, për rastet e parashikuara në shkronjën “c”, të pikës 10, të këtij vendimi. Në rastet e mosmiratimit të pezullimit sipas rastit, nga njësia e burimeve njerëzore apo Departamenti i Administratës Publike, ata duhet të bëjnë arsyetimin e vendimit të tyre.”.

c) Në pikën 14, pas fjalës “... konstatimit ...”, shtohen fjalët “... apo miratimit ...”.

ç) Pas pikës 15 shtohet pika 15/1, me këtë përmbajtje:

“15/1. Nëpunësi civil njofton institucionin për rikthimin në punë, jo më vonë se 7 (shtatë) ditë kalendarike përpara datës së përfundimit të afatit të pezullimit.

Faqe|14052

E njëjta procedurë ndiqet edhe në rastet kur nëpunësi civil do të ndërpresë periudhën e pezullimit më shpejt se afati për të cilin i është miratuar pezullimi.”.

d) Në pikën 16, pas fjalëve “... njësine përgjegjëse ...”, shtohen “... jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike përpara përfundimit të afatit të pezullimit...”, dhe në fund të paragrafit të parë shtohet fjalia “E njëjta procedurë ndiqet edhe në rastet kur nëpunësi civil do të ndërpresë periudhën e pezullimit më shpejt se afati për të cilin i është miratuar pezullimi.”.

dh) Pas pikës 16 shtohet pika 16/1, me këtë përmbajtje:

“16/1. Në rast se nëpunësi civil, i pezulluar për një afat më të gjatë se 3 (tre) muaj, nuk respekton afatin e njoftimit sipas përcaktimit në pikën 16, të këtij vendimi, dhe ky njoftim nuk është kryer deri në ditën e përfundimit të afatit të pezullimit, njësia përgjegjëse, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike nga dita e përfundimit të afatit të pezullimit, merr masa për të kërkuar nga nëpunësi shprehjen e tij me shkrim lidhur me vijimësinë e marrëdhënies në shërbimin civil.”.

e) Në pikën 23 fjalët “... i paaftë përgjithmonë ...” zëvendësohen me “... i paaftë për 2 (dy) vite radhazi, të pandërprera...”.

2. Për nëpunësit civilë, të cilëve u ka përfunduar periudha e pezullimit me kërkesën e tyre, për një nga rastet e parashikuara në nenin 55, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, deri më 1 janar 2019, dhe nuk kanë kryer procedurat e përcaktuara në shkronjat “a” deri në “dh”, të pikës 1, të këtij vendimi, t’i kryejnë ato brenda datës 31 janar 2019.

3. Efektet e këtij vendimi janë, si më poshtë vijon:

a) Për përcaktimin e shkronjës “e”, të pikës 1, fillojnë pas hyrjes në fuqi të vendimit;

b) Për të gjitha përcaktimet e tjera fillojnë nga data 1 janar 2019.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

**VENDIM****Nr. 748, datë 19.12.2018****PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 242, DATË 18.3.2015,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PLOTËSIMIN E VENDEVE TË LIRA NË
KATEGORINË E ULËT DHE TË
MESME DREJTUESE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 9, të nenit 26, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Në kreun II bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në pikën 5, pas fjalëve “... dhe qëndron e publikuar ...” shtohen “... të paktën ...”;

b) Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“9. Shpallja është e hapur për të gjithë nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet, pjesë të shërbimit civil. Dokumentacioni duhet të dorëzohet brenda datës së përcaktuar në shpalljen për konkurrim. Kjo datë përcaktohet duke siguruar që afati i dorëzimit të dokumentacionit të mos jetë më i vogël se 10 (dhjetë) ditë kalendarike nga dita e parë e shpalljes:

a) në faqen zyrtare të DAP-it dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, për institucionet e administratës shtetërore;

b) në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të internetit dhe në stendat e informimit të publikut, për institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.”.

c) Në pikën 15, fjalët “... nga data e paraqitjes së tyre ...” zëvendësohen me fjalët “... nga data e përfundimit të afatit të ankimit ...”.

ç) Fjalitë e fundit të pikave 28 dhe 30 shfuqizohen.

d) Në pikën 33 shtohet paragrafi, si më poshtë vijon:

“Nëpunësi civil detyrohet të paraqitet, pranë institucionit ku është emëruar, jo më vonë se 1 (një) ditë pune nga data e përfundimit të

dorëzimit të detyrës pranë institucionit të mëparshëm.”.

dh) Pas pikës 33 shtohen pikat 34 dhe 35, me këtë përmbajtje:

“34. Në rast të mosparaqitjes së nëpunësit civil brenda afatit të përcaktuar në pikën 33, të kreut II, të këtij vendimi, institucioni, ku nëpunësi është emëruar, njofton njësinë përgjegjëse brenda 5 (pesë) ditëve pune nga përfundimi i afatit. Në këtë rast njësia përgjegjëse vijon procedurën me anulimin e aktit administrativ (akti i emërimit), në zbatim të dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative.

35. Institucioni, ku nëpunësi civil është emëruar nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, detyrohet të nxjerrë aktin e fillimit të efekteve financiare jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune nga data e paraqitjes së nëpunësit në institucion. Këto afate mund të shtyhen me marrëveshje ndërmjet dy palëve, por jo më shumë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune nga data e nxjerrjes së aktit të emërimit nga njësia përgjegjëse.”.

2. Në kreun III bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6. Plotësimi i vendeve të lira me procedurën e ngritjes në detyrë është i hapur për nëpunësit civilë të një kategorie më të ulët në të njëjtin institucion apo institucione të tjera të shërbimit civil. Dokumentacioni duhet të dorëzohet brenda datës së përcaktuar në shpalljen për vendin e lirë. Kjo datë përcaktohet duke siguruar që afati i dorëzimit të dokumentacionit të mos jetë më i vogël se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike nga dita e parë e shpalljes.”.

b) Në pikën 26, fjalët “... nga data e depozitimit të ankesës ...” zëvendësohen me fjalët “... nga data e përfundimit të afatit të ankimit ...”.

c) Fjalitë e fundit të pikave 36 dhe 38 shfuqizohen.

ç) Në pikën 41 shtohet paragrafi, si më poshtë vijon:

“Nëpunësi civil detyrohet të paraqitet, pranë institucionit ku është emëruar, jo më vonë se 1 (një) ditë pune nga data e përfundimit të dorëzimit të detyrës pranë institucionit të mëparshëm.”.

d) Pas pikës 41 shtohen pikat 41/1 e 41/2, me këtë përmbajtje:



“41/1. Në rast të mosparaqitjes së nëpunësit civil brenda afatit të përcaktuar në pikën 41, të kreut III, të këtij vendimi, institucioni, ku nëpunësi është emëruar, njofton njësinë përgjegjëse brenda 5 (pesë) ditëve pune nga përfundimi i afatit. Në këtë rast njësia përgjegjëse vijon procedurën me anulimin e aktit administrativ (akti i emërimit), në zbatim të dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative.

41/2. Institucioni, ku nëpunësi civil është emëruar nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë, detyrohet të nxjerrë aktin e fillimit të efekteve financiare jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune nga data e paraqitjes së nëpunësit në institucion. Këto afate mund të shtyhen me marrëveshje ndërmjet dy palëve, por jo më shumë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune nga data e nxjerrjes së aktit të emërimit nga njësia përgjegjëse.”

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2019.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

VENDIM
Nr. 750, datë 19.12.2018

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 933, DATË 2.7.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRFAQËSIMIN E MINISTRISË SË BRENDSHME ME OFICERË KONTAKTI NË BRITANINË E MADHE, BELGJIKË, ITALI, GREQI, TURQI, KOSOVË, SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS, GJERMANI, FRANCË, EUROPOL DHE INTERPOL”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 84, të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 933, datë 2.7.2008, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Titulli i vendimit ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Për përfaqësimin e Ministrisë së Brendshme me oficerë kontakti në shtete të ndryshme dhe në organizata ndërkombëtare”.

Faqe | 14054

b) Në pikën 1, pas shtetit “Francë” shtohen shtetet “Holandë dhe Spanjë”.

2. Efektet financiare të këtij vendimi të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Brendshme, programi buxhetor “Policia e Shtetit”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

VENDIM
Nr. 751, datë 19.12.2018

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 910, DATË 21.12.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR ÇËSHTJET, OBJEKT KONSULTIMI, DHE STRUKTURËN, PROCEDURËN, FORMËN, MËNYRËN E ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT TË KËSHILLIT KONSULTATIV TË QEVERISJES QENDRORE ME VETËQEVERISJEN VENDORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 12, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 910, datë 21.12.2016, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shitesat, si më poshtë vijon:

1. Pika 7, e kreut III, “Krijimi, përbërja dhe drejtimi i Këshillit Konsultativ”, ndryshohet, me këtë përmbajtje:

“7. Përbërja e Këshillit Konsultativ të qeverisjes qendrore me vetëqeverisjen vendore është në përfaqësim të barabartë anëtarësh, 9 (nëntë) përfaqësues të qeverisjes qendrore dhe 9 (nëntë) përfaqësues të vetëqeverisjes vendore, si më poshtë vijon:

- Zëvendësministri përgjegjës për çështjet vendore, rendin dhe sigurinë;

- Zëvendësministri përgjegjës për fushën e financave;

- Zëvendësministri përgjegjës për çështjet e drejtësisë;

- Zëvendësministri përgjegjës për energjinë dhe infrastrukturën;



- Zëvendësministri përgjegjës për çështjet sociale;

- Zëvendësministri përgjegjës për integrimin evropian;

- Zëvendësministri përgjegjës për bujqësinë dhe zhvillimin rural;

- Zëvendësministri përgjegjës për mjedisin dhe turizmin;

- Zëvendësministri përgjegjës për arsimin;

- Kryetari i Shoqatës për Autonominë Vendore dhe 2 kryetarë bashkie, përfaqësues të Shoqatës për Autonomi Vendore;

- Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë dhe 2 kryetarë bashkie, përfaqësues të Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë;

- Kryetari i Shoqatës së Qarqeve dhe 2 kryetarë qarku, përfaqësues të Shoqatës së Qarqeve.”.

2. Pas pikës 17, të kreut IV, “Procedura e konsultimit të akteve dhe mbledhjet e Këshillit”, shtohet pika 17/1, me këtë përmbajtje:

“17/1. Mbledhjet e punës dhe mbledhjet plenare të Këshillit zhvillohen në prani të më shumë se gjysmës të të gjithë anëtarëve të tij. Për mospjesëmarrjen e anëtarëve njoftohen titullarët e institucioneve të përfaqësuara në Këshillin Konsultativ.”.

3. Në pikën 26, të kreut V, “Sekretariati teknik”, emërtimi “Agjencia për Zbatimin e Reformës Territoriale” zëvendësohet me “Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore” dhe shkurtimi “AZRT” zëvendësohet me “AMVV”.

4. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

VENDIM

Nr. 752, datë 19.12.2018

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ORGANIZIMIT, FUNKSIONIMIT DHE PËRCAKTIMIT TË MASËS SË SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË BORDIT TË APELIT TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 5 e 7, të nenit 193/b, të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore së organizimit, funksionimit dhe përcaktimit të masës së shpërblimit të anëtarëve të bordit të apelit të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Efektet financiare që lindin nga zbatimi i këtij vendimi, fillojnë pas botimit të tij në “Fletoren zyrtare”.

3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

RREGULLORE E ORGANIZIMIT, FUNKSIONIMIT DHE PËRCAKTIMIT TË MASËS SË SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË BORDIT TË APELIT TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE

Neni 1

Qëllimi

1. Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e rregullave dhe të procedurave lidhur me organizimin, funksionimin dhe përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të bordit të apelit të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale.



2. Bordi i apelit (në vijim BA) është organ i krijuar në bazë të nenit 193/b, të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar, (në vijim ligji) dhe shqyrton çështjet e zgjidhjes së konflikteve që lidhen me pronësinë dhe të drejtat mbi objektet e PI-së.

Neni 2

Përbërja, emërimi dhe lirimi i anëtarëve të BA-së

1. Bordi i apelit përbëhet nga pesë anëtarë, nga të cilët tre janë punonjës të DPPI-së dhe dy anëtarë të jashtëm të fushës së PI-së, të cilët plotësojnë kushtet për ekspertë të PI-së.

2. Kryetari i BA-së është drejtori i Përgjithshëm i DPPI-së.

3. Kandidatët për anëtarë në BA, nga radhët e punonjësve të DPPI-së, si dhe 2 anëtarët e jashtëm të përzgjedhur nga drejtori i Përgjithshëm nga kandidaturat e paraqitura, i propozohen për miratim këshillit mbikëqyrës, në fillim të çdo viti kalendarik, nga drejtori i Përgjithshëm i DPPI-së, për emërim si anëtarë të BA-së. Drejtori i Përgjithshëm, gjithashtu, e njeh këshillin mbikëqyrës me të gjitha kandidaturat që plotësojnë kushtet e pikës 1, të nenit 193/b, të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar, si dhe me arsyet e përzgjedhjes.

4. Në muajin nëntor të çdo viti do të shpallen dy vende vakante për vitin e ardhshëm kalendarik, për anëtarët e jashtëm të BA-së. Shpallja e vendeve vakante do të bëhet me njoftim në faqen zyrtare web të DPPI-së.

5. Kërkesa zyrtare për të kandiduar si anëtar i jashtëm i BA-së duhet të nënshkruhet nga vetë kandidati dhe duhet të shoqërohet me dokumentet e mëposhtme:

a) Të dhënat mbi identitetin personal, adresë korrespondence, e-mail dhe çdo pikë të saktë kontakti tjetër të parashikuar me ligj;

b) Jetëshkrim;

c) Diplomë e ciklit të dytë të studimeve “Master shkencor”;

ç) Çdo dokument tjetër që provon kontributin dhe njohuritë në fushën e PI-së.

Dokumentet e shkronjave “c” dhe “ç”, të kësaj pike, që nuk do të jenë origjinale ose të noterizuara, do të konsiderohen të padepozituara. DPPI-ja nuk do të dërgojë njoftim për plotësim dokumentacioni.

Faqe| 14056

Kërkesa zyrtare për të kandiduar si anëtar i BA-së, e pashoqëruar me dokumentet përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, e “ç”, të kësaj pike, do të konsiderohet e padorëzuar dhe, si e tillë, nuk do të shqyrtohet.

6. Lirimi i anëtarëve të BA-së bëhet nga këshilli mbikëqyrës për këto arsye:

a) Çdo anëtar i BA-së do të konsiderohet i liruar në fund të vitit kalendarik, me të drejtë riemërimi;

b) Me kërkesën e tij për dorëheqje;

c) Kur i është ndaluar ushtrimi i këtij aktiviteti me vendim gjyqësor të formës së prerë;

ç) Kur cenon më shumë se një herë, në mënyrë të pajustificuar, detyrimet që lindin në bazë të kësaj rregulloreje;

d) Me vendim të këshillit mbikëqyrës, për shkelje të rregullave të etikës.

7. Anëtari i BA-së, që jep dorëheqjen, sipas shkronjës “c”, të nenit 193/c, të ligjit, është i detyruar të paraqesë kërkesën me shkrim për dorëheqje dhe arsyet e dorëheqjes, të paktën një muaj përpara datës së lirimimit nga detyra, përveç rastit kur provon ose vërtetohet se kjo nuk ka qenë e mundur.

8. Mbledhja për shqyrtimin e çështjes së lirimimit të anëtarit të BA-së thirret nga drejtori i Përgjithshëm i DPPI-së.

Mbledhja për shqyrtimin e lirimimit të anëtarit të BA-së nuk zhvillohet pa e thirrur atë të marrë pjesë dhe të paraqesë shpjegimet e tij, përveç rastit kur kjo nuk është e mundur.

Vendimi i marrë në këtë mbledhje është i formës së prerë dhe zbatohet menjëherë.

9. Kryetari i BA-së dhe këshilli mbikëqyrës marrin masa për zëvendësimin sa më të shpejtë të anëtarit të liruar nga detyra, duke shpallur vendin vakant në faqen web të DPPI-së dhe duke proceduar si në pikat 4 e 5, të këtij neni. Afatet e procedimit në këtë rast përcaktohen nga kryetari i BA-së. Për çdo rast, këto afate nuk mund të jenë më të shkurtra se 7 (shtatë) ditë.

Neni 3

Sekretari teknik

1. Mbledhjet e BA-së asistohen nga sekretari teknik. Drejtori i Përgjithshëm cakton një punonjës të DPPI-së në rolin e sekretarit teknik në fillim të çdo viti kalendarik.



2. Sekretari teknik i BA-së është punonjësi i DPPI-së i cili ushtron këto detyra:

a) Merr në dorëzim me firmë të drejtorit të Përgjithshëm, dosjen e kërkesës së depozituar për shqyrtim pranë BA-së;

b) Është personi i autorizuar që konstaton fillimisht këto mangësi dhe dërgon njoftime për plotësimin e mangësive dhe/ose pasaktësive të kërkesës;

c) Njofton palët të depozitojnë pranë BA-së argumentet, prapësimet dhe çdo dokument tjetër të nevojshëm të përcaktuar në ligj dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave, për miratimin e rregullores së patentave, rregullores së disenjove industriale, rregullores së markave, rregullores së treguesve gjeografikë, rregullores së tarifave;

ç) Mban procesverbalin e mbledhjes me të gjitha elementet që duhet të përmbajë procesverbali, si dhe detyra të tjera të ngarkuara nga BA-ja.

3. Brenda 10 (dhjetë) ditësh nga plotësimi i të gjitha dokumenteve të përcaktuara me ligj, sekretari teknik një kopje të dosjes së plotë ia dërgon secilit anëtar të BA-së për njohje.

4. Sekretari teknik pasi merr nga drejtori i Përgjithshëm urdhrin për datën e mbledhjes së BA-së, ua komunikon atë së bashku me rendin e ditës anëtarëve me e-mail dhe/ose telefon.

Neni 4

Mbledhja e BA-së dhe vendimarrja

1. Mbledhjen e BA-së e çel kryetari.

2. Përpara fillimit të shqyrtimit të çdo çështjeje të re, sekretari teknik paraqet verbalisht përpara BA-së një pasqyrë të përmbledhur të kërkesave të palëve, fakteve dhe provave të depozituara në lidhje me çështjet dhe mban procesverbalin e mbledhjes dhe të diskutimeve të anëtarëve.

3. BA-ja, nën drejtimin e kryetarit, shtron për diskutim me radhë të gjitha çështjet që janë vendosur në rendin e ditës.

4. Në përfundim të të gjithë procedurës së shqyrtimit dhe të shkëmbimit të opinioneve nga anëtarët e BA-së, kryetari i fton anëtarët të votojnë. Së pari voton anëtari më i ri në moshë dhe së fundi voton kryetari i seancës. Asnjë nga anëtarët nuk mund të abstenojë nga vendimarrja. Votimi është i hapur në të gjitha

rastet. Mendimi i anëtarit të mbetur në pakicë, i parashtruar me shkrim, bashkohet me vendimin.

5. Në rast se rreth një çështjeje propozohen disa zgjidhje dhe votimi i parë është i barabartë, vota e kryetarit është vendimtare në përputhje kjo me nenin 15, të ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”.

6. Drejtori i Përgjithshëm cakton një anëtar të BA-së që, brenda 3 (tri) ditëve nga marrja e vendimit, të përgatisë vendimin e arsyetuar, një kopje e të cilit i dorëzohet sekretarit teknik për t’ia bashkëlidhur dosjes së çështjes.

7. Vendimi duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e BA-së që kanë marrë pjesë në dhënien e tij. Anëtari, mendimi i të cilit ka mbetur në pakicë, shkruan fjalën “kundër” dhe nënshkruan vendimin.

8. Vendimi i marrë i dorëzohet zyrës së protokollit të DPPI-së, për t’ia njoftuar atë palëve.

Neni 5

Shpërblimi i anëtarëve të BA-së

1. Kryetari, anëtarët dhe sekretari teknik i BA-së do të përfitojnë shpërblim për çdo mbledhje të BA-së.

2. Shpërblimi i kryetarit dhe i anëtarëve të BA-së është i barabartë në shumën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë, për çdo mbledhje të BA-së, por në çdo rast, numri i shpërblimeve nuk duhet të jetë më shumë se 6 pagesa në vit, pavarësisht nga numri i mbledhjeve të BA-së.

3. Shpërblimi i sekretarit teknik është i barabartë me shumën 5 000 (pesë mijë) lekë, për çdo mbledhje të BA-së, por në çdo rast, numri i shpërblimeve nuk duhet të jetë më shumë se 6 pagesa në vit, pavarësisht nga numri i mbledhjeve të BA-së.

4. Shpenzimet që parashikohen nga zbatimi i kësaj rregulloreje janë parashikuar të mbulohen nga buxheti i DPPI-së, si agjenci autonome.

**VENDIM**

Nr. 753, datë 19.12.2018

**PËR MIRATIMIN E
LETËRMARRËVESHJES NDRYSHUESE
NR. 2 TË MARRËVESHJES SË GRANTIT
NR. TF0A1769, NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR
RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, QË
VEPRON SI ADMINISTRATORE E
FONDEVE TË GRANTIT TË
AKORDUAR NGA FONDI I
MIRËBESIMIT ME SHUMË
DONATORË, PËR FINANCIMIN E
PROJEKTIT TË ZBATIMIT TË NISMËS
PËR TRANSPARENCË NË
INDUSTRINË NXJERRËSE
NË SHQIPËRI (EITI)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e letërmarrëveshjes ndryshuese nr. 2 të marrëveshjes së grantit nr. TF0A1769, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, që vepron si administratore e fondeve të grantit të akorduara nga Fondi i Mirëbesimit me Shumë Donatorë, për financimin e projektit të zbatimit të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse në Shqipëri (EITI), sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDESKRYEMINISTRI
Senida Mesi**

BANKA BOTËRORE**IBRD.IDA/GRUP I BANKËS BOTËRORE**

22 maj 2018

Sh.t. z. Arben Ahmetaj
Ministër i Financave dhe Ekonomisë
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Bulevardi Dëshmorët e Kombit, nr. 3
Tiranë
Republika e Shqipërisë

**Lënda: Granti EGPS për Zbatimin e
Financimit të Projektit të Zbatimit të Nismës
për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse**

**(Marrëveshja e Grantit nr. TF0A1769 dhe
TF0A6493)**

Amendimi nr. 2 i Letër Marrëveshjes

Shkëlqesi:

Ne i referohemi Letër Marrëveshjes (“Marrëveshja”) së datës 26 shkurt 2016, të ndryshuar, për zbatimin e Financimit të Projektit të Zbatimit të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (“Projekti”) ndërmjet Republikës së Shqipërisë (“Marrësi”) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (“Banka Botërore”), sipas të cilës Banka Botërore ka zgjeruar Grantin e sipërpërmendur (“Granti”).

Banka Botërore propozon ta amendojë Marrëveshjen si vijon:

1. Paragrafi i parë i Marrëveshjes në këtë mënyrë amendohet dhe ndryshohet në tërësi me tekstin e mëposhtëm:

“Në përgjigje të kërkesës për asistencë financiare të bërë në emër të Republikës së Shqipërisë (“Marrësi”), kam kënaqësinë t’iu informoj se Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (“Banka Botërore”), në cilësinë e administratorit të fondeve të grantit të dhënë nga Federata e Australisë, Kanadaja, Republika e Finlandës, Republika Federale e Gjermanisë, Mbretëria e Norvegjisë, Zvicra dhe Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës ë Veriut (“Donatorët”), në bazë të Mbështetjes Programatike Globale për Industrinë Nxjerrëse (EGPS) Fondi i Besimit me Shumë Donatorë, propozon t’i japë Marrësit një grant në shumën që nuk tejkalon një milion dollarë amerikanë (1,000,000 dollarë amerikanë) (Granti) që përbëhet nga: a) katërqind mijë dollarë amerikanë (400,000 \$)



(TF0A1769-granti fillestar); dhe b) gjashtëqind mijë USD (600,000 \$) (TF06493-granti shtesë) sipas termave dhe kushteve të përcaktuara ose të përmendura në këtë Letër Marrëveshjeje (“Marrëveshja”), e cila përfshin shtojcën bashkëlidhur, për të asistuar me financimin e Projektit të përshkruar në shtojcë (Projekti)”.

2. Seksioni 2.08 i shtojcës së Marrëveshjes me këtë ndryshohet dhe amendohet në tërësi me tekstin e mëposhtëm:

“2.08.Prokurimi

Të gjitha mallrat dhe shërbimet e konsulencës së kërkuara për Projektin dhe që do të financohen nga të ardhurat e Grantit do të prokurohen në

përputhje me kërkesat e përcaktuara ose të referuara në “Rregulloren e Bankës Botërore për Huamarrësit e IPF-së”, të muajit korrik 2016, të rishikuar në nëntor 2017 (“Rregulloret e Prokurimit”) dhe sipas parashikimeve të Marrësit për Planin e Prokurimit të Projektit (“Plani i Prokurimit”) të datës 30 prill 2018, të parashikuar sipas seksioni IV të Rregulloreve të Prokurimit, i cili mund të përditësohet herë pas herë në marrëveshje me Bankën Botërore.”

3. Tabela nën seksionin 3.01 të aneksit të Marrëveshjes është amenduar dhe zëvendësuar në tërësinë e saj me tekstin e mëposhtëm:

“Kategoria”	TF0A1769 Shuma e alokuar e (e shprehur në dollarë amerikanë)	Përqindja e Shpenzimeve për t'u financuar (duke përfshirë taksat)	TF0A6493 Shuma e alokuar e grantit (e shprehur në dollarë amerikanë)	Përqindja e shpenzimeve për t'u financuar (duke përfshirë taksat)
Mallra, shërbime konsulence, trajnime dhe kosto operative të projektit	400,000	100 %	600,000	100%
SHUMA TOTALE	400,000		600,000	

Të gjitha termat dhe kushtet e tjera të Marrëveshjes, përveç atyre të amenduara nëpërmjet kësaj letrë amendimi, do të mbeten në fuqi dhe efekt të plotë.

Ju lutem, konfirmoni Marrëveshjen e Marrësit me Amendimin e mësipërm, duke nënshkruar, duke vënë datën dhe duke e kthyer tek në kopjen bashkëngjitur të kësaj letrë amendimi. Kjo letër amendimi do të hyjë në fuqi nga data në të cilën Banka Botërore dërgon te Marrësi njoftimin për marrjen e njoftimit të Marrësit mbi mbylljen e procedurave të brendshme, të nevojshme për hyrjen e tij në fuqi sipas legjislacionit të Marrësit.

Me respekt,

**Banka Ndërkombëtare për Rindërtim e
Zhvillim**

Maryam Salim

Menaxhere vendi

Zyra e Bankës Botërore

Republika e Shqipërisë

MIRATUAR:

Republika e Shqipërisë

Nga: _____ Data: 15.11.2018

Përfaqësuesi i Autorizuar

Emri: **Arben Ahmetaj**

Pozicioni: Ministër i Financave dhe Ekonomisë

VENDIM

Nr. 754, datë 19.12.2018

**PËR SHPËRBLIMIN DHE
KOMPENSIMIN E DISA KATEGORIVE
TË VEÇANTA PËR FESTAT E
FUNDVITIT 2018**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2017”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përfituesit nga skema e ndihmës ekonomike dhe paaftësisë kompensohen financiarisht, për vitin 2018, në masën 3 000 (tre mijë) lekë, të ndarë sipas kategorive të mëposhtme:

a) Familje, të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike;

b) Familje, të cilat kanë në përbërje të tyre anëtarë me aftësi të kufizuara, të lindur ose të bërë të tillë, të cilët deklarohen të paaftë për punë me vendim të KMCAP-së, sipas pikës 3, të nenit 7, të



ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar;

c) Individët përfitues të statusit, sipas ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar;

ç) Individët përfitues të statusit, sipas ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, llogariten në shumën 396 147 000 (treqind e nëntëdhjetë e gjashtë milionë e njëqind e dyzet e shtatë mijë) lekë dhe përballohen nga buxheti i ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale, miratuar për vitin 2018.

3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

VENDIM

Nr. 755, datë 19.12.2018

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 752, DATË 13.12.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR EMËRIMIN E KRYETARIT DHE TË ANËTARËVE TË KËSHILLIT DREJTUES TË AUTORITETIT TË AVIACIONIT CIVIL”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 5, të ligjit nr. 10233, datë 11.2.2010, “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 1, të vendimit nr. 752, datë 13.12.2017, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

- Fjalët “Z. Sandër Lleshi, kryetar” zëvendësohen me fjalët “Z. Artan Shkreli, kryetar”;
- Fjalët “Z. Hajrulla Ceku, anëtar” zëvendësohen me fjalët “Znj. Elira Kokona, anëtar”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

VENDIM

Nr. 756, datë 19.12.2018

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “ZGJERIMI I VARREZAVE PUBLIKE”, BASHKIA CËRRIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Zgjerimi i varrezave publike”, Bashkia Cërrik.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Cërrik.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, për pasuritë e llojit “tokë arë”, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën 1, bashkëlidhur këtij vendimi, në vlerën 1 349 760 (një milion e treqind e dyzet e nëntë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, për pasuritë e llojit “tokë arë”, 1 349 760 (një milion e treqind e dyzet e nëntë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë) lekë, të përballohet nga llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2018, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në “Fletoren zyrtare”.

7. Pronarët e pasqyruar në tabelën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për



efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues pranë Bashkisë Cërrrik.

8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Elbasan, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Cërrrik, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Elbasan të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në

momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë në favor të shtetit për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Elbasan dhe Bashkia Cërrrik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi



TABELA ME LISTËN E PRONARËVE TË PASURIVE PRONË PRIVATE DHE VLERAT E SHPRONËSIMIT, PËR REALIZIMIN E PROJEKTTIT:

“ZGJERIMI I VARREZAVE PUBLIKE “, CËRRRIK

Çmimi për pasurinë e llojit “tokë arë”, sipas VKM nr. 89, datë 03.02.2016.

TABELA 1

Nr.	Emër Mbiemër	Zona Kadastrale	N/pasurisë	Pjesa takuese	Lloji i pronës	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera	Konfirmimi nga ZVRPP-ja
1	Caush Haziz Kamami	2559	24/23		tokë arë	m ²	2700	222	599400	Me shkresën nr. 3301/1 datë 27.10.2017
2	Bp: Ali Haziz Kamami; Caush Haziz Kamami; Rifat Haziz Kamami; Rabije Haziz Hysa; Shyqyri Haziz Kamami; Sheqere Haziz Mehilli	2559	24/21		tokë arë	m ²	980	222	217560	Me shkresën nr. 3301/1 datë 27.10.2017
3	Refije Dervish Kamani	2559	24/20	6/40	tokë arë	m ²	202.5	222	44955	Me shkresën nr. 3301/1 datë 27.10.2017
4	Petrit Shefqet Kamami	2559	24/20	6/40	tokë arë	m ²	202.5	222	44955	
5	Vjollca Shefqet Kamami	2559	24/20	6/40	tokë arë	m ²	202.5	222	44955	
6	Hamide Ibrahim Kamami	2559	24/20	5/40	tokë arë	m ²	168.75	222	37462	
7	Nertila Petrit Kamami	2559	24/20	5/40	tokë arë	m ²	168.75	222	37462	
8	Endrion Petrit Kamami	2559	24/20	5/40	tokë arë	m ²	168.75	222	37462	
9	Adi Petrit Kamami	2559	24/20	5/40	tokë arë	m ²	168.75	222	37463	
10	Qani Shefqet Kamami	2559	24/20	1/40	tokë arë	m ²	33.75	222	7493	
11	Perparim Shefqet Kamami	2559	24/20	1/40	tokë arë	m ²	33.75	222	7493	
12	Refije Dervish Kamani	2559	24/18/2	6/40	tokë arë	m ²	157.5	222	34965	Me shkresën nr. 3301/1 datë 27.10.2017
13	Petrit Shefqet Kamami	2559	24/18/2	6/40	tokë arë	m ²	157.5	222	34965	
14	Vjollca Shefqet Kamami	2559	24/18/2	6/40	tokë arë	m ²	157.5	222	34965	
15	Hamide Ibrahim Kamami	2559	24/18/2	5/40	tokë arë	m ²	131.25	222	29138	
16	Nertila Petrit Kamami	2559	24/18/2	5/40	tokë arë	m ²	131.25	222	29138	
17	Endrion Petrit Kamami	2559	24/18/2	5/40	tokë arë	m ²	131.25	222	29138	
18	Adi Petrit Kamami	2559	24/18/2	5/40	tokë arë	m ²	131.25	222	29137	
19	Qani Shefqet Kamami	2559	24/18/2	1/40	tokë arë	m ²	26.25	222	5827	
20	Perparim Shefqet Kamami	2559	24/18/2	1/40	tokë arë	m ²	26.25	222	5827	
VLERA TOTALE E SHPRONËSIMIT							6,080	222	1,349,760	

**VENDIM****Nr. 757, datë 19.12.2018****PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURISË
SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKET NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “REHABILITIMI I RRJETIT
RRUGOR, BASHKIA SHIJAK”, LOTI 1**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Rehabilitimi i rrjetit rrugor, Bashkia Shijak”, loti 1.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Shijak.

3. Pronarët e pasurisë së paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë e llojit “truall + objekt banimi”, në shumën totale prej 8 759 958 (tetë milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e tetë) lekësh.

4. Vlëra e përgjithshme e shpronësimit, prej 8 759 958 (tetë milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e tetë)

lekësh, të përballohet nga buxheti i Bashkisë Shijak.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2018, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në “Fletoren zyrtare”.

7. Pronarët e pasurisë së paluajtshme, në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Shijak.

8. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shijak, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Shijak, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit, mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasurinë e shpronësuar në favor të shtetit.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shijak të pezullojë të gjitha transaksionet me pasurinë e shpronësuar deri në momentin që të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, si dhe të bëhet kalimi i pronësisë për pasurinë e shpronësuar në favor të shtetit.

10. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Shijak dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shijak për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi



LISTA E PRONARËVE TË PASURISË PRONË PRIVATE QË SHPRONËSOHEN NGA PROJEKTI:

“Rehabilitimi i rrjetit rrugor, Bashkia Shijak”, loti 1

Çmimi për pasurinë objekt banimi sipas shkresës së ZVRPP

Çmimi për pasurinë truall sipas vendimit nr. 89, datë 3.2.2016.

INVESTITORI BASHKIA SHIJAK

Nr.	Emër Mbiemër	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sipërfaqja e përgjithshme e truall në m ²	Sipërfaqja e prekur truall në m ²	Çmimi për truall	Objekti sip.e përgj. në m ²	Objekti sip.e përgj. që preket në m ²	Çmimi për objekt banimi	Vlera (Truall i prekur nga shpronësimi) lekë	Vlera (Objekt i prekur nga shpronësimi) lekë	Vlera (Truall + Objekt i prekur nga shpronësimi) lekë	Konfirmimi nga ZVRPP Durrës
1	B.P. Nezaqet Deliallisi, Shefqet Deliallisi, Ymer Deliallisi, Zana Deliallisi	3369	4/28	276	175.7	3047	200.6	200.6	41, 000	535,358	8,224,600	8,759,958	Konfirmuar nga ZVRPP, me shkresën nr. 8378/1, datë 21.7.2017
SHUMA TOTALE				8 759 958									

**VENDIM****Nr. 758, datë 19.12.2018****PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA
REALIZIMI I PROJEKTIT “ZGJERIMI I
RRUGËS HYRËSE TË QYTETIT,
PARKIMI DHE RIKUALIFIKIMI I
QENDRËS SË QYTETIT KRUJË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Zgjerimi i rrugës hyrëse të qytetit, parkimi dhe rikualifikimi i qendrës së qytetit Krujë”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Krujë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall” dhe “ndërtesë”, me një vlerë të përgjithshme prej 46 656 922.66 (dyzet e gjashtë milionë e gjashtëqind e njëzet e dy pikë gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 46 656 922.66 (dyzet e gjashtë milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e

nëntëqind e njëzet e dy pikë gjashtëdhjetë e gjashtë) lekësh, të përballohet nga buxheti i Bashkisë Krujë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2018, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në “Fletoren zyrtare”.

7. Pronarët e përmendur në listën bashkëlidhur këtij vendimi të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Krujë.

8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Krujë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Krujë, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Krujë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Krujë dhe Bashkia Krujë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletore Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi



LISTA E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI “ZGJERIMI I RRUGËS HYRËSE TË QYTETIT, PARKIMI DHE RIKUALIFIKIMI I QENDRËS SË QYTETIT KRUIJË”

Nr.	Emër / Mbiemër	Zona Kadastrale	Nr. Pasurisë	Rrethi	Sip. e truallit (m²)	Sip. e ndërtimit (m²)	Çmimi i truallit (l/m²)	Vlera e truallit (lekë)	Vlera e ndërtimit (lekë)	Vlera totale	Shënime
1	Artur dhe Albana Topçiu	8621	5/102+2	Krujë	—	50.16	—	—	2,605,902.79	2,605,902.79	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Krujë. Pasuri e llojit Ndërtësë. Njësi shërbimi.
2	Afrim Kaçi	8621	3/980 N	Krujë	—	12.25	—	—	829,516.83	829,516.83	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Krujë. Pasuri e llojit Ndërtësë. Njësi shërbimi.
3	Eduart Çela	8621	3/475	Krujë	329.30	154.2 banesë 175.1 shërbim	4011	1,320,822.30	6,002,760.82 banesë 6,339,219 shërbim	13,662,802.12	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Krujë. Pasuri e llojit Truall + Ndërtësë. Objekt banimi dhe njësi shërbimi.
4	Enver Shuli	8621	3/1010	Krujë	305.80	36.1 banesë 80 shërbim	4,011	1,226,563.80	1694702.95 banesë 3492684 shërbim	6,413,950.75	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Krujë. Pasuri e llojit Truall + Ndërtësë. Objekt banimi dhe njësi shërbimi.
5	Argjend dhe Miftar Qesja	8621	5/284	Krujë	—	42.67	—	—	2,115,430.11	2,115,430.11	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Krujë. Pasuri e llojit Ndërtësë. Njësi shërbimi.
6	Fatos Herri	8621	3/952	Krujë	17.00	17.00	4011	68,187.00	861,758.05	929,945.05	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Krujë. Pasuri e llojit Truall + Ndërtësë. Njësi shërbimi.
7	Hektor Taga	8621	3/409 N2	Krujë	—	34.41	—	—	1,790,633.08	1,790,633.08	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Krujë. Pasuri e llojit Ndërtësë. Njësi shërbimi.
8	Ilirjan Taga	8621	3/409 N1	Krujë	—	34.41	—	—	1,984,142.88	1,984,142.88	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Krujë. Pasuri e llojit Ndërtësë. Njësi shërbimi.
9	Kujtim Vogli	8621	3/1175	Krujë	24.00	24.00	4011	96,264.00	1,507,914.96	1,604,178.96	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Krujë. Pasuri e llojit Truall + Ndërtësë. Njësi shërbimi.
10	Mereme Pikli, Kujtim Pikli dhe Mailinda Kulheku	8621	6/216- N	Krujë	—	45.00	—	—	2,093,679.90	2,093,679.90	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Krujë. Pasuri e llojit Ndërtësë. Njësi shërbimi.
11	Mehmet Emiri	8621	3/407 ND	Krujë	—	42.2 (1KT+P)	—	—	2,022,239.19	2,022,239.19	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Krujë. Pasuri e llojit Ndërtësë. Njësi shërbimi.
12	Meleq Herri	8621	5/359 N	Krujë	—	37.00	—	—	1,319,036.00	1,319,036.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Krujë. Pasuri e llojit Ndërtësë. Njësi shërbimi.
13	Kujtim Guni Afërdita Guni Arben Guni Meleq Guni dhe Paqaze Guni (Gjoni)	8621	3/1257	Krujë	2,315.00	—	4,011	9,285,465.00	—	9,285,465.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Krujë. Pasuri e llojit Truall.

VLERA TOTALE

46,656,922.66

**VENDIM****Nr. 759, datë 19.12.2018**

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 490, DATË 19.7.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “VLORA - ACU, RIKUALIFIKIM URBAN NË QYTETIN E VLORËS, PËRGJATË ‘P4 C2 A, B, C’”, DHE “NDËRTIM I RRUGËS – VAZHDIMI I UNAZËS VLORË – UJI I FTOHTË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 490, datë 19.7.2017, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 4 ndryshohet si më poshtë vijon:

“4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 165 224 816 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë milionë e dyqind e njëzet e katër mijë e tetëqind e gjashtëmbëdhjetë) lekësh, të përballohet nga llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.

2. Pasuritë të cilat preken nga projekti “Ndërtimi i rrugës - vazhdimi i unazës Vlorë – Uji i Ftohtë”, të paraqitura me numrat rendorë nga 1 në 13, në tabelën bashkëlidhur vendimit, ndryshojnë dhe zëvendësohen me ato sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi



LISTA E PRONARËVE TË PASURIVE, PRONË PRIVATE QË PREKEN NGA PROJEKTI “NDËRTIMI I RRUGËS- VAZHDIMI I UNAZËS VLORE-UJI I FTOHTË”, I NDRYSHUAR.

Nr.	Emër Mbiemër	Zona Kadastrale	Nr. Pasurisë	Rrethi	Sipërfaqja e ndërtimit (m²)	Sipërfaqja e truallit (m²)	Çmimi i ndërtimit (l/m²)	Çmimi i truallit (l/m²)	Vlera e ndërtimit (lekë)	Vlera e truallit (lekë)	Vlera Totale (truall+ndërtesë) (lekë)	KONFIRMIMI I ZVRPP-së
1	Bashkëpronarët Sadiku, Cenaj dhe Tahiraj	ZK. 8602	40/74	Vlorë	—	52.68	—	10903	—	574,370	574,370	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë, Pasuri e llojit Truall.
2	Bashkëpronarët Sadiku,	ZK. 8602	40/75	Vlorë	—	211.77	—	10903	—	2,308,928	2,308,928	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë, Pasuri e llojit Truall.
3	Evdhoqia Kissi	ZK. 8602	40/98/2	Vlorë	—	198	—	10903	—	2,158,794	2,158,794	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë, Pasuri e llojit Truall.
4	Bashkëpronarët Matathia	ZK. 8602	40/130	Vlorë	—	303.4	—	10903	—	3,307,970	3,307,970	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë, Pasuri e llojit Truall. Kjo pasuri përfshihet edhe te pasuria nr. 40/254 e kufizuar si pasojë e mbivendosjes 6798, dalë nga sistemi IPS. Në këtë pasuri ka një titull pronësie AMTP në emër të Shefik Avdurrahman. AMTP nr. 21085 në emër të Nezir Bocaj. AMTP nr. 21069 në emër të Luljeta Beshaj. Posedohet nga Baki Balili.
5	Mbivendosje	ZK. 8602	40/290	Vlorë	—	84	—	10903	—	915,852	915,852	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë, Pasuri e llojit Truall. Kufizohen veprimet deri në zgjidhjen e mbivendosjes.
6	Bashkëpronarët Sadiku	ZK. 8602	40/289	Vlorë	—	265	—	10903	—	2,889,295	2,889,295	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë, Pasuri e llojit Truall.
				Vlorë								
				Vlorë								
				Vlorë								
				Vlorë								



7	Martin Balili	ZK. 8602	40/271	Vlorë	—	380	—	10903	—	4,143,140	4,143,140	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë, Pasuri e llojit Truall.
8	Bashkëpronarët Koleka, Kleka dhe Kojana	ZK. 8602	40/132	Vlorë	—	768.3	—	10903	—	8,376,775	8,376,775	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë, Pasuri e llojit Truall. AMTP nr. 20759 në emër të Vasil Baka. Ka 6 ndërtime pa leje. Posedohen nga Merita Todor dhe Refat Tartari. Mbi këtë pasuri është regjistruar leje legalizimi nr. 6832.
9	Mbivendosje	ZK. 8602	40/265	Vlorë	—	365	—	204	—	74,460	74,460	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë, Pasuri e llojit pemëtore. Kufizim veprimesh AMTP nr 20760 dt. 08.05.2000 në emër të Merita Todor. Vendim gjykate nr. 788 dt. 02.04.2013,për fitimin e pronësissë mbi një sipërfaqe truall 400m². Ka një ndërtim pa leje. Kufizohen veprimet deri në zgjidhjen e mbivendosjes së konstatuar.
10	Bashkëpronarët Koleka dhe Hasanaj	ZK. 8602	41/10	Vlorë	—	68.75	—	10903	—	749,581	749,581	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë, Pasuri e llojit Truall. AMTP nr. 20774 në emër të Liljana Memaj.Planimetria e shitjes nuk përputhet me skicën e vendimit VKKP nr. 90 datë 18.10.1995 e BP Koleka. . Të kufizohen veprimet deri në plotësimin ref. 00016119. Blerje jashtë pronës në një sipërfaqe 400m², shitur nga prona me nr. 41/21.
11	Bashkëpronarët Jakohel, Efimovski, Shehu, Kajana, Koleka dhe Narito	ZK. 8602	41/5	Vlorë	—	1273	—	10903	—	13,879,519	13,879,519	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë, Pasuri e llojit Truall. Në këtë pasuri ka një objekt me sip. 92.6 m². Titulli I pronësisë së kësaj pasurie përfshin edhe pasurinë me nr 41/305 vol 56 F 141, të cilat janë kufizuar si pasojë e mbivendosjes. Sipërfaqja prej 3100 m² është hequr nga kjo parcelë pasi përfshihet në parcelën 77/5 e cila është hapur me regjistrim të veçantë. AMTP nr. 20780 në emër të Kaleme Licaj; AMTP nr. 20781 në emër të Neki Isai; AMTP nr. 20937 në emër të Alik Metaj. Ka një ndërtim pa leje. Posedohet nga Cane Metaj.
12	Gjergji Nika	ZK. 8602	77/5/1	Vlorë	—	540	—	10903	—	5,887,620	5,887,620	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë, Pasuri e llojit Truall. Nëpërmjet vendimit nr. 1126, datë 16.03.2018, të Gjykatës Administrative të Apelit, i është njohur bashkëpronarëve Koleka. Nga Kartela e Pasurisë nr. 77/5/1, ZK 8602, e konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë më datë 10.7.2018, pronar i pasurisë rezulton z. Gjergji Nika.



13	Koço Kume	ZK. 8602	78/2/1	Vlorë	—	53.5		204	—	10,914	10,914	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë, lloji i pasurisë është Ullishtë. Nr. i pasurisë në regjistrim të veçantë ka qenë 78/2, por ky nr. ka përplasje dhe si pasojë është zëvendësuar me 78/2/1. Ka një ndërtim pa leje. Sekuestro konservative.
14	Mbivendosje	ZK. 8602	41/305	Vlorë	—	180.5	—	204	—	36,822	36,822	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë, Pasuri e llojit pemëtore. Bashkëthemelues, AMTP nr. 21351 vendimi nr. 4, datë 1.12.2005 Laze Bejkosala. Kufizimi i veprimeve të pronarit mbi pasuritë derisa të provohet zgjidhja e mbivendosjes së konstatuar.
15	Arjan Tolaj	ZK. 8602	41/285/1	Vlorë	—	100.8		10903	—	1,099,022	1,099,022	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë, pasuri e llojit Truall.
16	Bashkëpronarët Velaj dhe Haxhiu	ZK. 8602	41/390	Vlorë	—	22.6	—	10903	—	246,408	246,408	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë, pasuri e llojit Truall. AMTP nr. 21973 në emër të Kadrie Xhaferri.
Vlera totale e shpronësimit										46,659,471		lekë

**URDHËR****Nr. 59, datë 18.12.2018****PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE**

Në mbështetje të neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore të Shqipërisë”, të vendimit të Kuvendit nr. 95/2016, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimin të pozicioneve të punës të institucionit të Autoritetit për Informim mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe të nenit 56, të vendimit nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, dhe nenit 11 të Rregullores së Brendshme të AIDSSH-së “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”.

URDHËROJ:

1. Delegimin e ushtrimit të kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor të Autoritetit për Informim mbi Dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit, z. Skënder Vrioni, Sekretar i Përgjithshëm, për të gjitha procedurat e prokurimit publik të institucionit.

2. Delegimin e përfaqësimit të Autoritetit në marrëdhëniet me të tretët, për çështje të karakterit administrativ të institucionit, Sekretarit të Përgjithshëm.

3. Delegimi i kompetencave mbaron me revokimin e aktit të delegimit.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm.

Ky urdhër hyn në fuqi në datën 21.12.2018 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Gentiana Sula

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 252 lekë